

VENDIM
Nr. 613, datë 17.9.2014

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT, TË PRONËS NR. 1051, ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR. 5013, N/REPART”, ME VENDNDODHJE NË BIGAZ, SKRAPAR”, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Sportit, të pronës nr. 1051, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 5013, N/repart”, me vendndodhje në Bigaz, Skrapar, sipas formularit standard të inventarizimit të pronës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për t’u përdorur për aktivitete sportive.

2. Prona nr. 1051, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 5013, N/repart”, me vendndodhje në Bigaz, Skrapar, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

3. Ministrisë së Arsimit dhe Sportit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITETËRORE
(Për inventarizimin e pronave si klasa të veçanta)

A		B				C				
Nr.	Zona kadastrale, indeksi i hartës	Numri i pasurisë	Emërtesa e pronës, vendodhja/ shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/ vendndodhja e komponentëve e përbërës	Përmasat e pronës në m ² ose MI	Funksioni për të cilin përdoret prona	Enti me përgjegjësi administrative	Enti përdorues statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
Komuna Qendër, Skrapar										
1051			Reparti ushtarak nr. 5013 n/repart		Bigaz Skrapar	119800 M ²	Për mbrojtjen	MM rep.usht. 5010 Tiranë	Reparti ushtarak nr. 5013 Berat	
				Trup-rojë		147				
				Depo ushqimi		78				
				Banjë		6				
				WC		6				
				Depo armatimi nr. 3		396				
				Depo armatimi nr. 4		396				
				Depo armatimi nr. 7		396				
				Depo armatimi nr. 8		396				
				Depo armatimi nr. 9		396				
				Depo armatimi nr.10		396				
				Depo armatim nr. 11		396				
				Depo veshmbathje nr. 19		600				
				Depo armatim nr. 12		600				
				Depo armatim nr. 13		192				
				Depo armatim nr. 14		192				
				Depo armatim nr. 16		396				
				Depo ndërldhje 20		192				
				Depo ish ofiqinë 17		45				
				Depo armatim nr. 18		396				
				Depo armatim nr. 1		396				
				Depo armatim nr. 2		396				
				Depo armatim nr. 5		396				
				Depo armatim nr. 6		396				
				Linjë elektrike		880 ml				
				Rrugë të brendshme		6000				
				Truall		112594				